

AKT-THEMELIMI

I

SHOQERISE "ANDI sh.p.k."



Sot me date 04.04.95, une Thodhori Gjikhuri, lindur dhe banues ne Vlore, themeloje shoqerine e quajtur "ANDI sh.p.k.", si administrator i vetem i saj. Kete akt-themelimi e kam formuluar ne baze te ligjit nr.7638 date 19.02.1992 dhe sa me poshte :

Neni 1

Shoqeria "ANDI sh.p.k." do te kete qendren ne Vlore, lagja "L.Sallata", nr.1321 dhe do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe mbi 10 vjet, me te drejte perseritje, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria "ANDI sh.p.k." do te kete per objekt te veprimtarise se saj: Ushtrimin e aktiviteteteve ne fushen e projektiveve e te ndertimeve te banesave familjare, industriale, social-kulturore, rrugeve, kanalizimeve, ujsjellesve, porteve, mirembajtje te objekteve te personave juridik shqiptar dhe te huaj ne Shqiperi si dhe tregtimi i materialeve te ndertimit.

Neni 3

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, vendqendrimin dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vednimit te marre nga administratori i saj.

Neni 4

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 leke te reja, i paguar nga administratori i saj ne Banken Kombetare Tregtare Vlore. Ky kapital mund te shtohet ne te ardhmen ne vartesi te aktivitetit te shoqerise.

Neni 5

Administratori per te ushtruar aktivitetin e percaktuar ne objektin e veprimtarise se shoqerise do te lidhe kontratat e punes sipas ligjeve ne fuqi me inxhinjere, ekonomiste, arkitekt, punonjes te fushave te ndryshme.

Neni 6

Shoqeria pergjigjet vete per detyrimet e saj ndaj te treteve brenda kapitalit te saj. Administratori i vetem Thodhori Gjikhuri mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

Neni 7

Shoqeria do te filloje aktivitetin e saj vetem pasi te kete marre lejen e organeve koptente sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 9

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykatën e Rrethit Vlore, ne perputhje me regjistracionin ne fuqi.

Neni 10

Ne rast te zgjidhjes se ketij Akti-Themelimi administratori i saj percakton menyren e likuidimit , sipas normave ligjore.


Neni 11

Ky akt-themelimi perpilohet ne kater kopje me fuqi te plote seicila per t'u paraqitur dhe depozituar ne organet gjyqesore, tatimore, noteri dhe nje kopje do te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Administratori i Shoqerise

"ANDI sh.p.k.

Thodhori Gjikauri



Vlore me 04/04/1995

Nr 22-47 i repert.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA


V E R T E T I M

Ne Vlore sot ne daten 04/04/1995 para meje IRENA BIMO, notere ne ket qytet u paraqit personalisht shtetasi: Thodhori Gjikauri, i biri i Krista -qit, lindur dhe banues ne Vlore, i vitlindjes 1955, i afte per te vepruar juridikisht, i identifikuar prej meje ne baze te ligjit, i cili me deklaroi se sa me siper eshte shprehje e lire e vullnetit te tij dhe nen-shkruan para meje noteres. Une noterja e legalizoj ne baze te ligjit.

NOTERE

IRENA BIMO

IRENA BIMO
NOTERE
22 575 VLORE



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ANDI sh.p.k."



Shtetasi Thodhori Gjikhuri me vullnetin e tij te krye vendosi themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ANDI sh.p.k." Krijimi i kesaj shoqerie eshte bere ne baze te K.Civil dhe te ligjit per shoqerite tregetare dhe aktiviteti i kesaj shoqerie do te ushtrohet ne baze te ketyre neve :

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar emertohet "ANDI sh.p.k."

Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte nga data e regjistrimit ne gjykate. Ajo do ta zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj.

Neni 2

Shoqeria "ANDI sh.p.k." ka seline e saj ne Republiken e Shqiperise, ne qytetin e Vlores, lagja "L.Sallata", nr.1321. Ajo mund te qele filiale, degje e perfaqesi ne qytete te tjere te Shqiperise ose jashte saj.

Neni 3

Pjesmarja ne kete shoqeri nuk e pengon themeluesin Thodhori Gjikhuri te kete pavaresi ligjore, te drejta pronesis brenda dhe jashte Shqiperise. Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet jashte veprimtarise se saj.

Neni 4

Shoqeria "ANDI sh.p.k." do te kete per objekt te veprimtarise se saj : Ushtrimin e aktivitetit ne fushen e projekteve e te ndertimeve te banesave familiare, industriale, social-kulturore, rrugeve, kanalizimeve, ujsjellseve, porteve, mirembajtje te objekteve te personave juridik shqiptar dhe te huaj ne Shqiperi si dhe per tregetin e materialeve te ndertimit/

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise do te jete 100.000 leke te reja, i depozituar prane Bankes Kombetare Tregetare Vlore nga administratori i kesaj shoqerie z.Thodhori Gjikhuri.

Neni 6

Shoqeria do te kryeje veprimtarine e saj pa kufizim, ne qdo rast mbi 10 vj et. Mbarimi i shoqerise do te jete me mbarimin e afatit neqoftese ky

nuk shtyhet me tej nga administratori si dhe per shkaqe te tjera qe para shikohen ne ligj.

Neni 7

Shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline si dhe objektin e veprimtarise sipas vendimeve qe do te marri administratori i shoqerise.

Neni 8

Struktura organizative e shoqerise :

Themeluesi i shoqerise z.Thodhori Gjikhuri do te jete edhe administratori i saj.

Administratori vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin dhe pakesimin e kapitalit themelor te shoqerise, kundrejt te tretteve, per emerimin e organit administrativ, per pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqefise, per ndryshimet e drejtimeve kryesore te veprimtarise se shoqerise. Administratori nenshkruan kontratat ne emer te shoqerise dhe per llogarë te saj, perfaqeson shoqerine para te tretteve dhe ne gjykata, puneson punonjes per realizimin e veprimtarise se saj. Sipas nevojave qe do ti paraqiten administratori do te lidhe kontrata pune si pas legjislacionit ne fuqi me specialiste te ndryshem si arkitekt, inxhinjer ndertimi e punonjes te specialiteteteve te ndryshem. Nga keta punonjes administratori do te emeruje organin administrativ.

Neni 9

Organi administrativ ka keto detyra :


- Te beje propozime para administratorit per dokumenta normative per veprimtarine e shoqerise.
- Te propozoje strukturen e aparatit te shoqerise, per ta vendosur ate administratori i saj.
- Te percaktoje ndarjen e vendeve te punes te atyre qe do te merren ne pune.
- Te paraqese para administratorit propozimet per regullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te veçanta, ndarjen e fitimeve si dhe percaktimin e regullave lidhur me shlyerjen e borxheve.
- Te perzgjedhe anetaret e komisionit te likuidimit, te cilet emerohen dhe revokohen nga administratori.
- Te paraqese propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 10

Vepirmtaria e shoqerise financiare realizohet ne baze te planeve financiare, qe bejne pjese ne planin e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

Planet financiare parashikojne aktivin dhe pasivin e veprimtarise se shoqerise, te shprehura ne ~~leke~~. Rezultatet financiare te veprimtarise se shoqerise caktohen ne baze te bilancit vjetor.

Neni 11



Bilancet vjetore duhet te paraqiten brenda dates 31 mars te vitit pasardhes nga organi administrativ, pasi te jete shqyrtuar me pare nga administratori i shoqerise. Bilanci kontabel miratohet nga administratori i cil vendos per krijimin e fondit te akumulimit, fondit rezerve etj.

Neni 12

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore te permendura me siper dhe shlyerjese e detyrimeve fiskale, i mbesin per perdorim administratorit

Neni 13

Shoqeria eshte prone e themeluesit te saj. Vendimet qe merr administratori, ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas normave te dokumentave te shoqerise, jane te detyrueshme per te gjitha punonjesit ne kete shoqeri.

Neni 14

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, i referohet plotesimeve qe do te behen nga administratori i shoqerise si dhe ligjeve te veqanta te legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen nete njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vet statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

Neni 15

Te gjitha kundershimet eventuale do te zgjidhen me mirekuptim, pa cenuar ligjet ne fuqi. Ne rast se nuk arrihet mirekuptimi mosmareveshjet mund te behen konflikt gjyqesor ne gjykatën e rrethit.

Neni 16

Shoqeria ka vulen e saj, ne te cilen eshte percaktuar sigla e saj dhe selia e shoqerise.

Neni 17

Ky statut perpilohet ne kater kopje me fuqi te plote secila, per tu para

qitur dhe depozituar ne organin gjyqesor, tatimor dhe noteri, kurse nje kopje do te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE

"ANDI sh.p.k."

Thodhori Gjikhuri



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA VLORE

Nr. 2248 rep.

v e r t e t i m :

Ne Vlore sot me date 04.04.1995 para meje Irena Bimo, notere ne kete qytet u paraqit personalisht shtetasi Thodhori Gjikhuri, i biri i Kristaqit, lindur ne Vlore me 1951 dhe me banim ne Vlore, lagja "L. Sallata" nr. 1321, i afte per te kryer veprime juridike, i identifikuar nga une noterja ne baze te ligjit, i cili me deklarof se sa me siper eshte shp hje e vullnetit te tij te lire dhe u nenshkrua regullisht nga ai para meje noteres dhe une noterja e legalizof ate ne baze te ligjit.

N O T E R E

Irena Bimo

IRENA BIMO
NOTERE
s 22575 VLORE

